



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 1 Datë 19.12.2018

PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË

Në mbështetje të neneve 149 dhe 179/6, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 280 të Ligjit Nr. 115/2016, “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr. 19/2018 “Për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, dhe të Vendimit datë 11.12.2018 të Mbledhjes së Përgjithshme të Prokurorëve “Për rezultatin e zgjedhjeve dhe shpalljen e fituesve”,

Ne, anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë,

të vetëdijshëm për përgjegjësinë me të cilën na ngarkon Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, me vendosmërinë për të ndërtuar sistemin e prokurorisë, bazuar në vlerat e pavarësisë, llogaridhënies, meritokracisë, integritetit dhe profesionalizmit,

me besimin se prokuroria e Republikës së Shqipërisë, do të jetë në lartësinë e detyrave që i ngarkon Kushtetuta dhe shoqëria shqiptare,

VENDOSIM:

Të deklarojmë krijimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë të Republikës së Shqipërisë.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

ALFRED BALLA

ANTONETA SEVDARI

ARBEN DOLLAPAJ

BESNIK CANI

BUJAR SHESHI

GENT IBRAHIMI

GENTJAN OSMANI

KOSTAQ BELURI

NURIHAN SEITI

SANDËR BECI

TARTAR BAZAJ

